



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 259/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Radika” SHPK në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-88681-03-01-2021 me objekt me Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2021”, me fond limit 7 499 920 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

Ankimues: “Radika” SHPK
Rruga “Siri Kodra, ish –blloku i magazinave, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër
Blv: “Elez Isufi” Peshkopi.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.03.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “prokurimit “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-88681-03-01-2021 me objekt “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2021”, me fond limit 7 499 920 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 25.03.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 02.04.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Radika” SHPK	6.028.450 lekë	skualifikuar
2. “2N” SHPK	6.163.514 lekë	skualifikuar

3. “Shehu” SHPK.	6.240.154 lekë	kualifikuar
4. “Doda R” SHPK	6.503.260 lekë	skualifikuar
5. “Nika” SHPK	6.757.670,97lekë	kualifikuar
6. “Alko Impex General Construcion” SHPK	6.840.887,76 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 02.04.2021 operatori ekonomik “Radika” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen si më poshtë: *Bazuar ne dokumentet e ngarkuara nga ana juaj ne sistemin elektronik SPE , per permbushjne e kritevere per këte objekt prokurimi, ju nuk plotesoni pikat si me poshte.*

1-Inxhinieri Hidroteknik Z. Besmir Muca nuk eshte si drejtues teknik ne licencën e shoqerise.

2- Deshmite e sigurimit teknik te ngarkuara ku eshte kerkuar nuk pasqyrojne faqen e vlefshmerise se tyre.

3-Nuk keni ngarkuar dokumentacion per mjetin (Ekskavator me goma).

4-Nuk keni ngarkuar dokuemntacion per betoforma.

II.4. Në datën 08.04.2021 operatori ekonomik “Radika” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Më datë 02.03.2021AK Bashkia Dibër ka publikuar në SPE procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm. Në datën 19.03.2021 AK ka ngarkuar në SPE shtojcën nr. 1 (modifikimin e kriterëve) dhe po në datën 19.03.2021 ka ngarkuar në SPE shtojcën nr. 2 (modifikimin e kriterëve), duke caktuar datën 25.03.2021 si datë përfundimtare për pranimin e ofertave. OE “Radika” ShPK ka marrë pjesë në këtë procedurë duke paraqitur ofertën e saj sipas kriterëve të përcaktuara në DST shtojcën 1 dhe 2 (shtojcë për modifikimin e kriterëve).

Më datë 02.04.2021 ora 15:59 jemi njoftuar me vendimin e KVO-së elektronikisht nëpërmjet SPE për vlerësimin e procedurës së prokurimit të cituar më sipër i cili skualifikon oe “Rdika” ShPK për arsyet si më poshtë vijon:

Bazuar ne dokumentet e ngarkuara nga ana juaj ne sistemin elektronik SPE, per permbushjne e kriterëve per këtë objekt prokurimi, ju nuk plotesoni pikat si me poshte.

1-Inxhinieri Hidroteknik Z. Besmir Muca nuk eshte si drejtues teknik ne licencën e shoqerise.

2- Deshmite e sigurimit teknik te ngarkuara ku eshte kerkuar nuk pasqyrojne faqen e vlefshmerise se tyre.

3-Nuk keni ngarkuar dokumentacion per mjetin(Ekskavator me goma).

4-Nuk keni ngarkuar dokuemntacion per betoforma.

Vendimi i KVO është në kundërshtim me LPP-në përkatësisht neni 55 pika 1;2;3; dhe 4. Për këtë argumentojmë si më poshtë vijon:

Pretendimi I

Në DST dhe shtojcën 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST) pika 2.3.5 ju keni kërkuar:

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori I shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

Në deklaratën e paraqitur nga oe "Radika" ShPK është përcaktuar inxhinieri Xhelil Shini dhe inxhinieri Kadri Muca do të jenë drejtues teknik të objektit. Pretendimi i ngritur nga ana juaj se inxhinieri hidroteknik Besmir Muca nuk është drejtues teknik i licencës së OE "Radika" ShPK nuk qëndron pasi oe "Radika" ShPK në deklaratën e drejtuesit teknik të kërkuar nga AK Bashkia Dibër nuk ka specifikuar se inxhinieri hidroteknik Besmir Muca është drejtues teknik i oe-së "Radika" ShPK për objektin që prokurohet. Inxhinieri hidroteknik Besmir Muca është pjesë e stafit të operatorit ekonomik "RADIKA" ShPK ku plotëson kriterin e kërkuar nga ana juaj në st dhe shtojcën nr. 2 përkatësisht pika 2.3.7 ku kërkohet:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë të siguruar në listëpagesa nje punonjes që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë), që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Per specialistin e kërkuar më sipër, duhet të paraqitet:

- certifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj. Ky kriter është plotësuar me inxhinierin hidroteknik Z. Besmir Muca. Në DST dhe në shtojcën 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST) në pikën 2.3.5 kërkohet:

2.3.5 O.E duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licencë:

- inxhinier ndërtimi, 1 (nje)*
- inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (nje)*
- inxhinier hidroteknik, 1 (nje)*

Për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, CV përkatëse, librezat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

OE "Radika" ShPK ka plotësuar kriterin për inxhinierin e ndërtimit dhe hidroteknik duke paraqitur dokumentacionin (diplomë, CV, librezën e punës) për inxhinierin Xhelil Shini, i cili është drejtuesi teknik i operatorit ekonomik "Radika" ShPK me licencën me nr. NZ.2778/9. Drejtuesi Teknik Ing. Xhelil Shini është diplomuar në universitetin shtetëror të Tiranës në vitin 1970 me numër diplome 778-8, dega inxhinieri ndërtimi me specialitet ndërtime qytetare dhe industriale. Dega hidroteknik deri në vitin 1970 ka qenë e përfshirë në degën e ndërtimit pra inxhinieri i ndërtimit ishte dhe inxhinier hidroteknik.

Kjo vertetohet edhe nga licenca e operatorit ekonomik " RADIKA " ShPK., ku operatori ekonomik ka përfituar kategorine NP- 6A (Diga dhe tunele hidroteknike), kategori e cila referuar VKM Nr.42, date 16.1.2008 "Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe

ushtrojne veprimtari ndertimi" lidhen drejtperdrejte me disponimin e stafit teknik, inxhinier hidroteknik. Pra kjo kategori mbeshtetur VKM Nr.42; date 16.1.2008 perfitohet nga Inxhinieri Hidroteknik dhe Inxhinierit i Ndertimit/profili Inxhinier per Ndertime Qytetare Industriale me diplome te perfituar para vitit 1971. Per sa argumentuar me siper duke u mbeshtetur ne VKM nr. 42 date 16. O 1.2008, operatori ekonomik " RADIKA" sh.p.k. ka si drejtues teknik ndertimi dhe hidroteknik, inxhinierin Xhelil Shini.

Per sa argumentuam me siper pretendimi Juaj se inxhinieri hidroteknik Besmir Muca nuk eshte drejtues teknik nuk qendron, pasi edhe vete operatori ekonomik " RADIKA " sh.p.k. nuk e ka deklaruar si drejtues teknik, pasi ai nuk eshte pjese e licencës se operatorit ekonomik por ploteson kriterin 2.3.7 dhe jo kriterin 2.3.5 te percaktuar ne D.S.T.Kriteri 2.3.5 i DST dhe shtojces nr.2 eshte plotesuar nga inxhinieri Xhelil Shini dhe Inxhinieri Kadri Muca.

Pretendimi II

Ne DST dhe ne shtojcen nr.2 (shtojca e fundit per modifikimin e kriterëve te D.S.T), ne piken 2.3.6 kerkohet :

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në muajin e fundit ne listëpagesen e shoqërisë stafin me pershkrimet:

- | | |
|-----------------------------|--|
| <i>1. Teknik ndërtimi ,</i> | <i>1 (Nje) Diplome dhe dëshmia e kualifikimit e sigurimit teknik</i> |
| <i>2. Shofer</i> | <i>2 (dy) Leje drejtimi për kamion</i> |
| <i>3. Murator</i> | <i>1 (nje) Dëshmi e kualifikimit profesional dhe dëshmi e kualifikimit e sigurimit teknik.</i> |

Gjithashtu ne piken 2.3.8 kerkohet :

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë te pasqyruar ne listepagesen e fundit te shoqerise dhe me kontrate pune të lidhur specifikisht per realizimin e objektit te prokurimit specialistët dhe pershkrimet si me poshte:

- | | |
|-----------------------|---|
| <i>1. Hekurlidhës</i> | <i>1 (Nje) (i pajisur me dëshmi kualifikimi profesional)</i> |
| <i>2. Saldator</i> | <i>1 (Nje) (i pajisur me dëshmi kualifikimi profesional dhe dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik).</i> |
| <i>3.Manovrator</i> | <i>2 (dy) (i pajisur me dëshmi kualifikimi profesional dhe dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik)</i> |

OE " RADIKA " sh.p.k. ka paraqitur dëshmite e kualifikimit te sigurimit teknik sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor per :

- a) Teknik Ndertimi - dëshmia me numer 012034*
- b) Murator - dëshmia me numer 007527*
- c) Saldator - dëshmia me numer 006127*
- d) Manovrator - dëshmia me numer 019337 dhe 006268*

Pretendimi i ngritur nga ana Juaj se nuk eshte dorezuar faqja ku eshte vlefshmeria e deshmise se kualifikimit nuk eshte mbeshetur mbi kriterin e percaktuar nga ana Juaj ne DST dhe ne shtojcen nr.2 (shtojca e fundit per modifikimin e kriterëve të D.S.T), pika 2.3.6 dhe 2.3.8.Ne kriterin e vendosur ne piken 2.3.6 dhe 2.3.8 eshte kerkuar vetem deshmia e kualifikimit te sigurimit teknik dhe nuk eshte kerkuar informacion shtese per deshmine e kualifikimit te sigurimit teknik (vlefshmeria). Mbeshtetur ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr.103/2018, neni 55 pika 2 citohet :

2. Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentet e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter, qe nuk eshte perfshire ne dokumentet e tenderit.

KVO ka përdorur për skualifikimin e oe një kriter i cili nuk është vendosur në pikën 2.3.6. dhe 2.3.8 të DST dhe në shtojcën nr. 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST).

Në DST dhe në shtojcën 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST), në pikën 2.3.3. ju keni kërkuar: 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë : Sistemi i menaxhimit te cilesise (ISO 9001- 2015 e vlefshme)*
- Certifikatë : Sistemi i menaxhimit te mjedisit (ISO 14 001-2015 e vlefshme)*
- Certifikatë : Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS – 18001-2007 e vlefshme) ose ISO 45001-2018*
- Certifikatë : Sistemi i menaxhimit te cilesi ne saldim (ISO 3834-2:2006 e vlefshme)*

Gjithashtu në DST dhe në shtojcën nr. 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST), pika 2.3.9./a/c ju keni kërkuar:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur jane ne pronesi duhet të paraqitet:

dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit(i vlefshëm), taksat (i vlefshëm) si dhe foto e mjetit ku të dallohet targa.

c) Për mjetet e siguruara me qira të paraqitet:

dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), akt pronësia , certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (e vlefshëm), foto e mjetit ku te dallohet targa. Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates ku të specifikohet objekti i prokurimit ne fjale, dhe te deklarohet nga qiradhënësi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter ku të specifikohet dhe afati i saj. Pra edhe ne piken 2.3.9/a/c ju si Autoritet Kontraktor e keni specifikuar qe operatori ekonomik duhet te paraqesë edhe faqen ku paraqitet vlefshmeria e dokumentit.

Per sa argumentuam me siper ju si Autoritet Kontraktor ne piken 2.3.6 dhe 2.3.8 te DST dhe shtojces nr.2 nuke keni specifikuar qe operatori ekonomik duhet te paraqese edhe informacion per vlefshmerine e certifikates sic e keni kerkuar ne piken 2.3.3 dhe piken 2.3.9/a/c. Mbeshtetur ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr.103/2018, neni 55 pika 2, Ju nuk duhet ta perdorni si kriter per skualifikim.

Gjithashtu ne ligjin 162/2020, neni 92 " Shqyrtimi i ofertave ", pika 3 citohet :

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Mbeshtetur ligjit 162/2020, neni 92, pika 3, po ju dergojme faqen e vlefshmerise per te treguar se deshmita e kualifikimit te sigurimit teknik per specialistet e kerkuar nga ana Juaj kane qene te vlefshme ne fazen e zhvillimit te tenderit dhe nuk jane dorezuar pasi nuk jane kerkuar nga ana Juaj.

a) teknik ndërtimi -dëshmia me numer 012034, dt. Lsh. 22/03/2021- dt.sk.21/03/22

b) Murator - deshmita me numer 007527, dt. Lsh. 22/03/2021- dt.sk.21/0322

c) Saldator - deshmita me numer 006127, dt. Lsh. 22/03/2021- dt.sk.21/03/2022

d) Manovrator - deshmita me numer 019337, dt. Lsh. 22/03/2021- dt.sk.21/03/2022

e) Manovrator - deshmita me numer 006268, dt. Lsh. 22/03/2021- dt.sk.21/03/2022

Per sa argumentuam me siper, pretendimi i ngritur nga ana Juaj nuk qendron pasi eshte ne kundërshtim me ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr.103/2018 neni 55 pika 2.

Pretendimi III

Ne DST dhe ne shtojcen nr.2 (2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST).

2.3.9 ju keni kerkuar :

2.3.9 Operatori ekonomik duhet paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë si me poshte:

Nr.	Mjetet	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 8 ton)	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
4	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Betoforma	në pronësi ose me qira	150 m ²
7	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Depozite uji mbi 500 l	në pronësi ose me qira	Copë 3

9	Gjenerator elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Saldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit(i vlefshëm), taksat (i vlefshëm) si dhe foto e mjetit ku të dallohet targa.

b) Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi duhet te paraqitet: kontrata e blerjes, zhdoganimi ne Shqiperi ose (kalimi ne regjim te perkohshem) dhe faturat tatimore perkatese.

c) Për mjetet e siguruara me qira të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), akt pronësia , certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (e vlefshme), foto e mjetit ku te dallohet targa. Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates ku të specifikohet objekti i prokurimit ne fjale, dhe te deklarohet nga qiradhënësi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter ku të specifikohet dhe afati i saj.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.

Per kete duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikohet edhe vendndodhja e mjeteve (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

OE "Radika" ShPK ka paraqitur shtojcën 9 (deklarata e makinerive sipas formatit dhe kërkesës së përcaktuar në DST. [...])

Në shtojcën 9 (deklarata e makinerive) oe "Radika" ShPK ka deklaruar se disponon eskavator me goma copë 2. Në spe oe "Radika" ShPK ka ngarkuar dokumentacionin e makinerive në dosjen me emërim "makineritë". Në këtë dosje është ngarkuar kontrata noteriale nr. 1200rep, të lidhur më datë 230.12.2004 për shitblerjen e ekskavatorit tip MH4. Dokumenti është ngarkuar në dosjen me emër "makineritë" me numër rendor 12-13.

Gjithashtu oe "Radika" ShPK ka ngarkuar kontratën për shitblerjen e eskavatorit të përdorur me goma të lidhur më datë 03.03.2021 e cila shoqërohet me faturën tatimore nr. 0. Dokumenti ndodhet në dosjen me emër "makineritë" me numër rendor 14-15.

Për sa argumentuam më sipër pretendimi juaj nuk qëndron pasi oe "Radika" ShPK ka paraqitur dokumentacionin e duhur se disponon dy ekskavatorë me goma.

Pretendimi IV

Në dst dhe në shtojcën nr. 2 (shtojca e fundit për modifikimin e kriterëve të DST), në pikën 2.3.9. ju keni kërkuar: 2.3.9 Operatori ekonomik duhet paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë si me poshte:

Nr	Mjetet	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 8 ton)	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
4	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
6	Betoforma	në pronësi ose me qira	150 m ²
7	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Depozite uji mbi 500 l	në pronësi ose me qira	Copë 3
9	Gjenerator elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Saldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1

- Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur janë në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri), certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (i vlefshëm) si dhe foto e mjetit ku të dallohet targa.

b) Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur janë në pronësi duhet të paraqitet: kontrata e blerjes, zhdoganimi në Shqipëri ose (kalimi në regjim të perkohshem) dhe faturat tatimore perkatese.

c) Për mjetet e siguruara me qira të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri), akt pronësia, certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (e vlefshëm), foto e mjetit ku të dallohet targa. Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qirase/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjale, dhe të deklarohet nga qiradhënësi qe mjeti nuk i është dhene me qira ndonje subjekti tjetër ku të specifikohet dhe afati i saj.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr.9.

Per kete duhet te paraqese nje deklarate ku te specifikohet edhe vendndodhja e mjeteve (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

OE radika ka paraqitur shtojcën 9 (deklarata e makinerive) sipas fformatit të kërkesës së përcaktuar në dst.

referojmë deklaratën e makinerive [...]

Ne shtojcen nr.9 (deklaratë e makinerive) O.E. "RADIKA" ka deklaruar se disponon betoforma ne sasine 260 m2. Ne sistemin SPE O.E. "RADIKA" ShPK. ka ngarkuar dokumentet e makinerive ne dosjen me emrin "makinerite". Ne kete dosje eshte ngarkuar fatura tatimore e shtijes me numer 107 per betoformat, sasia e betoforma eshte 8m3, e konvertuar ne metra katror eshte 266 m2, ne piken 2.3.9 kerkohet 150m2.

Dokumenti ndodhet ne dosjen me emër "makinerite" me numer rendor 23.

Per sa argumentuam me siper, pretendimi Juaj nuk qendron pasi O.E. "RADIKA" ShPK ka paraqitur dokumentacionin se disponon 266 m2 betoforma.

Për sa parashtruam më sipër kërkojmë:

Pezullimin e procedurës së prokurimit duke u mbështetur në LPP dhe në vkm 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar

Shqyrtimin e ankesës tonë kualifikimin e oe "Radika" ShPK[...]

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP, nga autoriteti kontraktor, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresën nr.1192/1 prot, datë 14.04.2021, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik "Radika" SHPK duke e pranuar pjesërisht atë dhe konkretisht (citojmë):

1. [...]Lidhur me sa me siper KSHA arsyeton:

Sic citohet edhe me siper, Operatoret ekonomike ofertues per te permbushur kete pike, duhet te kene drejtues teknik te pershire ne License , respektivisht Inxhinier Ndertimi (Nje) , Inxhinier Gjeodet/Topograf/Makshajder (Nje) dhe Inxhinier Hidroteknik (Një). Pretendimi juaj qe Z.Xhelil Shini i ploteson te dyja pikat nuk qendron pasi cdo inxhinier ne kantierin e punes ka detyrat funksionale dhe per kete arsye Autoriteti kontraktor ka kerkuar 3 drejtues teknike te sipercituar dhe jo nje inxhinier qe te kryeje te gjitha funksionet. Keshtu qe i njejti person nuk mund te kryeje dy funksione, pare edhe ne qofte se do te merret parasysh nga ana jone qe z.Xhelil Shini eshte me profesion inxhinier hidroteknik, atehere juve ju mungon inxhinieri i ndertimit duke pasur dhe parasysh qe inxhinier Gjeodet/Topograf/Makshajder keni Z.Kadri Muca. Dhe per rrjedhoje ju si operatore ekonomik keni vetem dy drejtues teknik, dhe nga ana e AK Bashkia Diber jane kerkuar tre drejtues teknik siç cituam dhe me siper.

Sa me siper pretendimi juaj nuk qendron.

2. [...]Lidhur mesa me siper KSHA arsyeton:

Sa me siper cituar edhe bazuar ne pretendimet tuaja , Komisioni shqyrtimit te ankesave thekson qe dokumentacioni i ngarkuar nga ana juaj konsiderohet i plote kur ai ploteson te gjitha elementet thelbesore, gjithashtu bazuar edhe ne ligjin e cituar nga ana juaj per kete rast (Komisioni i vleresimit te ofertave ka vepruar drejte, pasi ju nuk jeni skualifikuar sepse dokuemtacioni ka pasur paqartesi ne shkrim apo shtypje, por ketij dokumentacionit i mungojne elementet thelbesore sic eshte vlefshmeria e tij) Pra vlefshmeria e IQT-ve eshte element thelbesor e ketij dokumenti dhe mos shfaqja e ketij elementi e ben te pavlefshem ate.

Sa me siper Pretendimi juaj nuk qendron.

3. [...]Lidhur me sa me siper KSHA arsyeton:

Per pretendimin e sipercituar nga ana juaj, eshte e vertete qe ju keni plotesuar deklaraten mbi disponueshmerine e mjeteve , por per te vertetuar qe ju dispononi mjetin Ekskavator me Goma ne pronesi ose me qira duhet qe te kishit bashkelidhur te gjitha dokumentacionin e nevojshem per kete mjet i cili duhet te jete ne perputhje me kondin rrugor te Republikes se Shqiperise, ku te gjitha mjetet me goma qe qarkullojne ne gjendje te lire duhen te pajisen: me certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshem), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (e vlefshme), foto e mjetit ku te dallohet targa gjithashtu duke u bazuar dhe ne shtojcen Nr.2 per modifikim kriteresh me konkretisht:

Mjetet me goma duhet të jenë të pajisur me certifikatën e kontrollit teknik (i vlefshëm), siguracionin e mjetit (i vlefshëm), taksat (e vlefshëm) foto e mjetit ku të dallohet targa. Për të cilin ju skeni ngarkuar asgjë.

Sa me siper Pretendimi juaj nuk qendron.

4.[...] Lidhur mesa me siper KSHA arsyeton:

Per sa me siper cituar, gjate perlllogaritjes te konvertimit nga m3 ne m2 nga ana e KVO eshte perlllogaritur gabimisht sasia e betofermes dhe si rrjedhoje kane dale ne kete konstatim. Ne këtë rast sipas fatures tatimore te paraqitur per betoforma rezulton se ju e plotesoni kete pike. Si rrjedhojë pretendimi juaj qëndron.

VENDOSI:

- 1. Pranimin e pjesshem te ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik "RADIKA" ShPK.*
- 2. Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit te Autoritetit Kontraktor Bashkia Diber.*
- 3. I rekomandojme Tititullarit Autoritetit Kontraktor te marre masat e nevojshme per zbatimin e ketij vendimi.*
- 4. Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik, brenda 10 diteve nga e nesërmja e komunikimit te ketij vendimi.[...]*

II.7. Në 23.04.2021 operatori ekonomik "Radika" SHPK ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik me të njëjtin objekt anekese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1419/1 prot., datë 04.05.2021, protokolluar me tonën në datën 06.05.2021, me objekt "Dërgim informacioni në lidhje me vendimin tuaj nr. 689/1 datë 27.04.2021, për procedurën e prokurimit me REF-88681-03-01-2021", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Radika” SHPK për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*1-Inxhinieri Hidroteknik Z.Besmir Muca nuk është si drejtues teknik në licencën e shoqërisë.*” , Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” , pika 2.3.5. “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

2.3.5 O.E. duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licencë:

- *inxhinier ndërtimi, 1 (një)*
- *inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (një)*
- *inxhinier hidroteknik, 1 (një)*

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, CV përkatëse, librezat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror. Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori I shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

III.1.2. Në shtojcën 1 ”modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ishte:

2.3.5 O.E. duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licencë:

- *inxhinier ndërtimi, 1 (një)*
- *inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (një)*
- *inxhinier hidroteknik, 1 (një)*

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, CV përkatëse, librezat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror. Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori I shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

Bëhet:

2.3.5 O.E. duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licencë:

- inxhinier ndërtimi, 1 (një)
- inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (një)
- inxhinier hidroteknik, 1 (një)

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, si dhe të figurojnë në muajin e fundit ne listëpagesen e shoqërisë.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror. Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori I shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

III.1.3. Në shtojcën 2 ”modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

ishte:

2.3.5 O.E. duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licence:

- inxhinier ndërtimi, 1 (një)
- inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (një)
- inxhinier hidroteknik, 1 (një)

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, CV përkatëse, librezat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror. Drejtuesi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori i shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori I shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

bëhet:

2.3.5 O.E. duhet të ketë Drejtuesit Teknik në licencë:

- inxhinier ndërtimi, 1 (një)
- inxhinier gjoedet/topograf/makshajder, 1 (një)
- inxhinier hidroteknik, 1 (një)

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatoret Ekonomike duhet të paraqesin diplomat respektive, si dhe të figurojnë në muajin e fundit ne listëpagesën e shoqërisë.

Drejtuessi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër shtetëror. Drejtuessi/t teknik i/të shoqërisë nuk duhet të jetë/në të punësuar në asnjë subjekt tjetër privat në rolin e drejtuesit teknik.

Për këtë shoqëria duhet të paraqesë një deklaratë nga Administratori i shoqërisë dhe të deklarojë se autorizon Autoritetin Kontraktor për verifikimin e informacionit të dhënë. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

III.1.4. III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimes “Radika” ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Deklaratë e shoqërisë ku paraqiten emrat e drejtuesve teknikë të cilët do të drejtojnë punimet.

Licencën Profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtim zbatimit NZ. 2778/9 në emër të shoqërisë Radika. Drejtues ligjor: K. M.; Drejtues Teknik: K. M., Xh. Sh., R. K., I. I.[..]

Kontratë Pune datë 03.03.2015 lidhur ndërmjet Shoqëria Radika ShPK në cilësinë e punëdhënësit dhe Xh.Sh. në cilësinë e Punëmarrësit me profesion Ing Ndërtimi. Licencë Z.1182/3. Diplomë Nr.778-8 lëshuar nga UT në degën ndërtim me titull Inxhinier Ndërtimi me specialitet ndërtime qytetare industriale. Librezë Pune.CV.

Kontratë Pune datë 15.12.2018 lidhur ndërmjet Shoqëria Radika ShPK në cilësinë e punëdhënësit dhe K.M. në cilësinë e Punëmarrësit me profesion Ing Gjeodet. CV. Diplomë Nr.B-1495 lëshuar nga UT në degën minierave me titull inxhinier Miniere. Librezë Pune.

Kontratë Pune datë 03.02.2020 lidhur ndërmjet Shoqëria Radika ShPK në cilësinë e punëdhënësit dhe B.M. në cilësinë e Punëmarrësit për vendin e punës drejtues teknik. CV. Diplomë Bachelor Nr.B-901 lëshuar nga UPT Diplomë master profesional në Inxhinieri Hidroteknike. Librezë Pune.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”.

III.1.6. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 “Kontratat për Punë Publike” pika 8 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon” a licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në

dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.7. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, 12 makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit , të dokumenteve të procedurës së prokurimit si më sipër cituar, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar disponimi nga operatorët ekonomikë të drejtuesve teknikë në licencë përkatësisht: 1 (një) inxhinier ndërtimi, 1 (një) inxhinier gjeodet/topograf/makshajder; 1 (një) inxhinier hidroteknik. Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion si: diplomat respektive, si dhe të figurojnë në muajin e fundit në listëpagesen e shoqërisë. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga ky i fundit në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm. Konkretisht, nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni konstatohet se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacion për tre inxhinierë përkatësisht: inxhinier ndërtimi, z. Xh.Sh., inxhinier gjeodet/topograf/makshajder z. K.M., inxhinier hidroteknik z. B. M., ku nga verifikimi ky i fundit konkretisht inxhinieri hidroteknik z. B. M. nuk figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, pavarësisht për të cilin është paraqitur dokumentacioni i kërkuar si diplomë në inxhinieri hidroteknike, kontratë pune, CV dhe librezë pune etj. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, nga verifikimi licencës profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtim zbatimit NZ. 2778/9 në emër të shoqërisë Radika ShPK., rezulton se inxhinieri hidroteknik z. B. M., nuk figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se drejtuesi teknik përkatësisht inxhinieri i ndërtimit do të kryejë edhe funksionin e inxhinierit hidroteknik është e pabazuar pasi operatori ekonomik ka në licencën e shoqërisë vetëm dy drejtues teknikë, ndërsa autoriteti kontraktor në kërkesat e përcaktuara nga ky i fundit në dokumentet e tenderit konkretisht pika 2.3.5. e kapacitetit teknik ka kërkuar në licencën e shoqërisë 3 inxhinierë respektivisht një inxhinier ndërtimi, një inxhinier Gjeodet/Topograf/Makshajdër dhe një inxhinier hidroteknik.

Në sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në lidhje me drejtuesin teknik, respektivisht inxhinierin hidroteknik, kështu që rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi operatori ekonomik “Radika” ShPK nuk plotëson pikën 2.3.5. të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

III.1.8. Akoma më tej, vlen të theksojmë se, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor për sa i përket dokumenteve të tenderit, publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësisht të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave të mësipërme, ai gjithashtu ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës

ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Radika” ShPK për procedurën e prokurimit, “Kërkesë për Propozime”, Nr. REF-88681-03-01-2021 me objekt me “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje e kanaleve ujitëse, Bashkia Dibër, 2021”, me fond limit 7 499 920 leke pa TVSH, zhvilluar në datën 25.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 689 Protokoli; Datë 23.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri